



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

## Raport për tremujorin e katërt 2023

Oda e Mjekëve të Kosovës



Janar 2024

Prishtinë

## **Përmbajtja:**

Raport për tremujorin e katërt 2023 .....	1
1. Infrastruktura Juridike .....	3
2. Këshilli Drejtues.....	4
3. Anëtarësimi .....	5
4. Mbikëqyrja etiko-profesionale.....	6
5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional .....	7
6. Licencimet.....	8
7. Këshilli Mbikqyrës .....	8
8. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së.....	9
9. Komisioni për Edukim Specialistik .....	9
10. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke .....	9
11. Raporti financiar.....	9
12. Prokurimi .....	11
13. Aktivitete të tjera .....	11
13.1 Revsita Mjeku – Shëndetësia jonë .....	11
13.2 Marrëveshja për Delegimin e Fondeve dhe Implementim.....	11
13.3. Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike .....	16
14. Plani i veprimit për 2024.....	16

## **1. Infrastruktura Juridike**

Gjatë periudhës tetor-dhjetor 2023 është mbajtur një (1) mbledhje nga Kuvendi i OMK-së.

Me datë 26 dhjetor 2023 u mbajt mbledhja e Kuvendit të V-të, ku janë prezantuar plotësim-ndryshimet e Rregulloreve nga Komisionet e Përhershme të Odës, Rregulloret e aprovuara me propozimet e reja ishin:

- Plotësim-ndryshimi i Rregullorës së Komisionit të Antaresimit, Licencimit dhe Rilicencimit;
- Plotësim-ndryshimi i Rregullorës për Menaxhimin e Financave të OMK-së;
- Plotësim-ndryshimi i Rregullorës për Procedurat e Prokurimit në OMK-ë;
- Plotësim-ndryshimi i Rregullorës për përcaktimin e shkeljeve etike dhe procedurat e mbikqyrjes Etike.

Gjithashtu u bë edhe dhënia e betimit nga përfaqësuesit e ri të njësisve zgjedhore atë të Spitali i përgjithshëm i Vushtrrisë dhe Klinikës së Gjinekologjisë.

## 2. Këshilli Drejtues

Në periudhën kohore tetor-dhjetor 2023, Këshilli Drejtues i OMK-së ka mbajtur tri (3) takime si dhe në 3 rast kanë votuar elektronikisht përmes e-mailit ku janë shqyrtuar lëndët si më poshtë:

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën tetor-nentor	Vendimet/Përgjigjet sipas kërkesave/ ankesave të pranuar për periudhën tetor-nentor	Vendimet në procedurë	Vendimet e Këshillit Drejtues për periudhën tetor-dhjetor	Vendime/Pergjigje për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
<b>Këshilli Drejtues i Odës</b>	6	13	0	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vendim për përcaktimin e taksës për publikim të artikullit të sponsorizuar në Revistën Mjeku;</li> <li>- Vendim për vendimin e Këshillit Drejtues për dhënien e të drejtës së OE për prezantojnë produktet në panairin e Kongresit;</li> <li>- Vendim lidhur me propozimin e Komisionit Ad Hoc për Dhënien e Dekoratave për pensionistët e vitit 2023 dhe post mortum gjatë vitit 2023;</li> <li>- Vendim lidhur me kërkesën e Prof. Dr Salih Ahmeti për mbështetje financiare për librin Pandemia Covid-19 dhe sfidat e mantelbardhëve;</li> <li>- Vendim lidhur me trajnimin në Komunën e Prishtinës për trajnimin në fushën e Ultrasonografisë së Abdomenit</li> </ul>	0

### 3. Anëtarësimi

Gjatë periudhës kohore Tetor – Dhjetor 2023, në Odën e Mjekëve të Kosovës u anëtarësuan 59 mjekë, nga të cilët 1 mjekë i punësuar në sektorin publik, 8 mjekë të punësuar në sektorin privat, 50 mjekë të papunë dhe 0 mjekë në pension.




Tabela 1.1: Anëtarësimet për periudhën kohore Tetor – Dhjetor 2023




Tabela 1.2: Totali i përgjithshëm i anëtarëve deri më datën 31 Dhjetor 2023

Gjatë kësaj periudhe janë ndarë nga jeta 2 mjekë si dhe janë rianëtarësuar 33 mjekë, si rezultat numri total i anëtarëve deri me datën 31 dhjetor është 5284 mjekë.

#### 4. Mbikëqyrja etiko-profesionale

Për ta pasqyruar ecurinë e mbikëqyrjes etike dhe profesionale pranë Prokurorit të OMK-së, në mënyrë tabelare do të paraqesim ushtrimin e funksionit të tillë nga ana e Prokurorit të OMK-së.


ORGANI	Numri i lëndëve të pranuarra për periudhën T4	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për periudhën T4	Sanksionet e shqiptuarapër periudhën T4	Sanksionet e ekzekutuara për periudhën T4	Lëndët e bartura nga periudhat paraprake	Lëndët në shqyrtim
Prokurori i Odës	19	13	N/A	N/A	14	20

<b>Këshilli Etik</b>	12	13	Qortim Publik 2	Rekomandime Kolegiale 3	16	15
<b>Gjyqi i Nderit</b>	1	1	///	///	///	///
<b>Certifikatate të kaluarës etike</b>	156	///	///	///	///	///

Me datë 02.11.2023 është mbajtur takimi i KES, në të cilin është dhënë përgjigje në kërkesën për mbrojtje juridike të datës 15 shtator 2023. Dhe me datë 19.12.2023 është mbajtur takimi i radhës ku është diskutuar lidhur me draftimin e rregullores së Komisionit.


## **5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional**

Komisioni për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional gjatë periudhës Tetor-Dhjetor 2023 ka akredituar 57 aktivitete. Në kuadër të aktiviteteve të akredituara, 7 prej këtyre akreditimeve janë me taksë administrative si në grafikun e mëposhtëm:



## 6. Licencimet

Komisioni për Licencim dhe Rilicencim profesional gjatë periudhës Tetor – Dhjetor 2023, ka lëshuar 242 licenca me kategoritë si më e mëposhtëm:



## 7. Këshilli Mbikqyrës

Gjatë periudhës tetor-dhjetor 2023 Këshilli Mbikqyrës i OMK-së ka mbajtur tre (3) takime ku i kanë shqyrtuar Raportin e punës së OMK-së për tre mujorin e tretë të vitit 2023, Vendimet e Këshillit Drejtues, Këshillit Etik, Prokurorit,



Gjyqit të Nderit të OMK-së dhe të organeve të tjera të OMK-së, gjithashtu kanë dhënë rekomandime për përmirësimin e punës së OMK-së.

## 8. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së

Në periudhën kohore Tetor- Dhjetor 2023, Komisioni për Çështje Etike i OMK-së ka pranuar gjithsej 45 kërkesa për leje-hulumtim dhe janë marr 45 vendime ku prej tyre 18 janë vendime për leje-hulumtim, 20 vendime për kthim raporti, 2 vendime refuzuese, 4 vendime për zgjatje afatit, dhe 1 vendim për plotësim ndryshim të lëndës.

## 9. Komisioni për Edukim Specialistik

Në periudhën kohore tetor- dhjetor 2023, Komisioni për Edukim Specialistik ka mbajtur një (1) takim. Përgjatë këtij takimi komisioni ka diskutuar për Udhëzimin Administrativ për Shkollim Specialistik 01/2023.

## 10. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke

Në periudhën kohore Tetor –Dhjetor 2023, Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së ka pranuar katër(4) kërkesa për përkrahje financiare.Komisioni ka nxjerrë katër (4) vendime pas aprovimit të kërkesave të parashtruara nga palët.

## 11. Raporti financiar

Raporti Financiar deri me 31 Dhjetor 2023

1.0 Të hyrat:					
1.1 Paraja në bankë me 31.12.2022	€ 810,867				
<b>Total Paraja në bankë me 31.12.2022</b>			<b>€810,867</b>		
1.2 Të hyrat	Realizimi: TM1	Realizimi: TM2	Realizimi: TM3	Realizimi: TM4	TOTAL
1.2.1 Të hyrat nga anëtarësia:					
1.2.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	€ 271,885	€ 92,721	€ 25,529	€ 3,895	€ 394,030

1.2.3 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jo kosovarë	€ 3,380	€ 3,520	€ 1,500	€ (240)	€ 8,160
1.2.2 Licencimi	€ 20,250	€ 14,130	€ 14,430	€ 12,370	€ 61,180
1.2.3 Të hyrat e tjera*	€ 11,229	€ 11,777	€ 68,396	€ 83,044	€ 174,446
<b>Të hyrat deri me 31.12.2023</b>	<b>€ 306,744</b>	<b>€ 122,147</b>	<b>€ 109,855</b>	<b>€ 99,069</b>	<b>€ 637,816</b>
<b>Paraja në bankë me 31.12.2022</b>					<b>€ 810,867</b>
<b>TOTAL TË HYRAT</b>					<b>€ 1,448,683</b>

2.0 SHPENZIMET	Shpenzimet: TM1	Shpenzimet: TM2	Shpenzimet: TM3	Shpenzimet: TM4	TOTAL
2.1 Paga, meditje dhe kontributet pensionale	€ 66,904	€ 57,578	€ 68,763	€ 90,197	€ 283,441
2.2 Material shpenzues	€ 2,220	€ 2,905	€ 289	€ 1,076	€ 6,489
2.3 Reprerentacioni	€ 1,033	€ 561	€ 658	€ 641	€ 2,893
2.4 Edukimi i vazhdueshëm profesional	€ 16,671	€ 94,698	€ 34,615	€ 81,466	€ 227,450
2.5 Shpenzimet e tjera*	€ 12,855	€ 12,624	€ 18,102	€ 32,493	€ 76,074
2.6 Shpenzimet e asetëve	€ 2,895	€ 1,550	€ -	€ -	€ 4,445
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	€ 2,000	€ -	€ 3,000	€ 7,450	€ 12,450
Llogaritë e pagueshme me 31.12.2022	€ 9,510				€ -
Llogaritë e pagueshme me 31.12.2023	€ (10,542)	€ (6,313)		€ 9,745	€ 9,745
<b>TOTAL SHPENZIMET 31.12.2023</b>	<b>€ 103,546</b>	<b>€ 163,604</b>	<b>€ 125,426</b>	<b>€ 213,323</b>	<b>€ 622,988</b>
<b>Neto të hyrat për TM 4 - 2023</b>	<b>€ 203,198</b>	<b>€ (41,456)</b>	<b>€ (15,571)</b>	<b>€ (114,253)</b>	<b>€ 14,828</b>
<b>TOTAL BILANCI 31.12.2023</b>					<b>€ 825,695</b>

1.2.3\*Taksë administrative për aplikim për ndërrim të kartelës, Regjistrimi në regjistrin e anëtarësisë së OMK-së, Riregjistrim në regjistrin OMK, Faksimili, Faksimili i dytë, Certifikata për të kaluarën etike profesionale, Taksa për paraqitjen e provimit, Kongreset, simpoziumet, seminarët, Lejimi për hulumtime për persona juridik, Të ardhurat nga interesi BKT, Dhurata / donacione, Të hyrat nga Marrëveshja për Delegim të Fonde dhe Zbatim (DAFI KSV/017 21 2749), Të ardhurat të tjera.

2.5\*Faksimili, Shpenzimet për botimin e revistës, Organizimi i mbledhjeve të kuvendit, Shpenzimet e ID kartelave të Odë, Shpenzime të përkthimeve/lektorimit, Meditje për udhëtime zyrtare, Trajnime për stafin, Mirembajtja e softverit për financa, Shpenzimet e tel., Shpenzimet e int., Shpenzimet e postës, Pajisje të IT, Shpenzime bankare, Shpenzimet e pastrimit, Shpenzimet e transportit, Shpenzimet e tjera operative.

## **12. Prokurimi**

Gjatë periudhës kohore tetor – dhjetor 2023 u zhvillua procedurë e hapur e prokurimit Kontrat për hapsirën e mbajtjes së eventeve të OMK-së, ku dhe është arritur marrëveshje tre veçare me operatorin ekonomik të suksesshëm.

Në muajin tetor, me procedurë të hapur është bërë përzgjedhja e operatorit të suksesshëm ekonomik, kontratë për shërbime të transportit ajror, ku dhe është nënshkruar marrëveshje një veçare.

## **13. Aktivite të tjera**

### **13.1 Revsita Mjeku – Shëndetësia jonë**

Numri 3, vëllimi 4 i Revista Mjeku trajton temën Shëndetësia jonë dhe është botuar në muajin dhjetor 2023.

Disa nga temat që janë trajtuar në këtë numër janë: Pse duhet që programi specialistik të menaxhohet nga OMK?, bankat indore dhe biobankat, dhurimi i organeve me qëllim të transplantimit, menaxhimi i mbeturinave medicinale në Kosovë, mjeku në pension, gratë në kirurgjinë ortopedike, mjekët artistë etj.

21 artikuj të ndryshëm përbëjnë këtë numër të përmbledhura në 64 faqe në total.

Revista është publikuar në Ëeb-faqe të OMK-së dhe faqen zyrtare të Facebookut.

Numri i radhës i Revsita Mjeku pritet të publikohet gjatë muajit mars 2024.

(Linku: [Revsita Mjeku](#) ).

### **13.2 Marrëveshja për Delegimin e Fondeve dhe Implementim**

Oda e Mjekëve të Kosovës dhe projekti i Luxembourg Development KSV/017, në vitin 2022 kanë nënshkruar marrëveshje për delegimin e fondeve

dhe implementimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me ndërtimin e kapaciteteve të stafit mjekësor të Spitaleve të Përgjithshme të Gjilanit dhe Prizrenit.

Marrëveshja ka të bëjë me zbatimin e aktiviteteve të programit për trajnimin dhe zhvillimin profesional të mjekëve të spitaleve përkatëse. Program i cili është hartuar mbi planin e menaxhimit të burimeve njerëzore për periudhën 2022-2026 dhe përmes këtyre trajnimeve mjekët e këtyre spitaleve do të kenë mundësi të ngrisin shkathtësitë dhe njohuritë e tyre në aspektin profesional.

Në këtë drejtim Oda e Mjekëve në bashkpunim me Spitalin e Përgjithshëm të Gjilanit dhe Prizrenit, kanë identifikuar nevojat për trajnime dhe si rezultat ka filluar procesi i rekrutimit të trajnerave të kualifikuar apo insitucioneve për të implementuar trajnimet e nevojshme.

Nga muaji korrik deri në muajin nëntor 2023 u organizua në QKUK trajnimi nga lëmia e laparaskopisë. Qëllimi i trajnimit është aftësimi profesional i stafit për kryerjen e intervenimeve nga lëmia e laparaskopisë në Spitalin e Përgjithshëm Prizren. Poashtu reparti i Kirurgjisë i Spitalit të Përgjithshëm Prizren është një ndër repartet kirurgjike model në Kosovë. Reparti i këtij spitali është renovuar në tërësi dhe është pajisur me aparturë modene.

Ndërsa prej muajit Shtator 2023 u organizua në QKUK trajnimi nga lëmia e kardiologjisë intervente dhe planifikohet që trajnimi të zgjasë 4 deri në 6 muaj. Krijimi i departamentit të Kardiologjisë Intervente në Spitalin e Përgjithshëm në Prizren është një projekt kombëtar i rëndësishëm për shëndetësinë publike.

Trajnimi ka fokus teknikat intervente (invazive) për trajtimin e sëmundjeve të zemrës dhe të enëve të gjakut. Ky trajnim do të sigurojë njohuri dhe aftësi të nevojshme për mjekët në fushën e kardiologjisë intervente, që do të ndihmojë krijimin e

departamentit të Kardiologjisë Intervente në Spital Përgjithshëm në Prizren. Ky shërbim i ri do të rrisë kapacitetin e kujdesit shëndetësor në rajonin e Prizrenit dhe do të sjellë një ndryshim të rëndësishëm në trajtimin e pacientëve me sëmundje të zemrës.

Projekti i Luxembourg Development KSV/017, në vitin 2022 fillimisht ka alokuar vlerën prej 120,000.00€ kurse në fund të vitit 2022 pas suksesit të treguar nga OMK për realizimin e trajnimeve, marrëveshjes bazë i është shtuar amandamenti 1, ku janë alokuar mjete shtesë për implementimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve të odës, si dhe mbështetjen për organizimin të trajnimeve profesionale-profilizimeve për një numër të përzgjedhur të mjekëve nga spitalet e përgjithshme të Gjilanit dhe Prizrenit.

Si pjesë e amandamentit 1 të marrëveshjes (DAFI KSV/017•21 2749), përfaqësues nga Oda e Mjekëve të Kosovës në bashkëpunim me përfaqësues nga projekti i Qeverisë së Luksemburgut për shëndetësi KSV/017 dhe përfaqësues nga Spitali i Përgjithshëm i Gjilani dhe Prizrenit kanë vizituar Spitalin e Përgjithshëm Izola, Murska Sobota dhe Celje në Slloveni. Qëllimi i kësaj vizite ka qenë për të diskutuar dhe finalizuar marrëveshjen për realizimin e trajnimeve profesionale për mjekët e Spitalit të Përgjithshëm të Gjilanit dhe Prizrenit. Mjekët e Spitalit të Gjilanit dhe Prizrenit do të përfitojnë nga marrëveshja e trajnimeve profesionale që do zgjasin sipas kërkesave dhe nevojave, e që kryesisht do të jenë të fokusuara nga lëmia e Kardiologjisë intervente, Laparaskopisë, Mjekësisë Emergjente dhe Menaxhimit shëndetësor dhe cilësisë të Spitaleve.

Me datë 17 mars 2023, OMK ka nënshkruar marrëveshje partneriteti me Spitalin e Përgjithshëm Izola, Murska Sobota dhe Celje nga Sllovenia për ngritjen e kapaciteteve klinike të stafit mjekësor të Spitaleve të Përgjithshme të Gjilanit dhe Prizrenit. Kjo marrëveshje bashkëpunimi do të shërbejë si platformë për shkëmbimin e përvojave më të mira dhe gjithashtu do t'u mundësojë mjekëve të Spitaleve të Prizrenit të Gjilanit dhe Spitaleve Sllovene të përfitojnë dhe zhvillohen profesionalisht përmes shkëmbimit të përvojave.

Si pjesë e marrëveshjes me spitalet Sllovene në muajin nëntor, një mjek specialist i kardiologjisë dhe dy infermiere nga Spitali i Përgjithshëm Celje kanë mbajtur trajnim një javor në Spitalin e Përgjithshëm të Prizrenit. Pjesëmarrës në këtë trajnim kanë qenë 23 mjekë specialist të kardiologjisë dhe infermier, ku gjithashtu dhe mjekë nga klinika e kardiologjisë e QKUK-së kanë marr pjesë në këtë trajnim.

Gjatë këtij trajnimi janë prezantuar disa aspekte të sistemit slloven të kardiologjisë intervente me theks të veçantë në rolin e kardiologjisë

intervenuese në praktikën e përditshme si dhe në trajtimin dhe prognozën e pacientit. Gjithashtu u bë krahasimi i fluksit ditor të punës ndërmjet dy departamenteve të kardiologjisë dhe u debatua duke marrë parasysh dallimet dhe specifikat e dy mjediseve të ndryshme. Fokus i trajnimit ishte edhe prezantimi i vlerës së EKG-së në sindromat koronare dhe aritmitë, specifika dhe ndjeshmëria e saj si dhe dobia e saj në situata të ndryshme klinike ku dhe gjithashtu në fokus ishin edhe udhëzimet për sindromat koronare akute dhe kronike u prezantuan me theks në opsionet bashkëkohore të trajtimit si dhe në afatin kohor të ngjarjeve kardiovaskulare dhe parandalimin e tyre.

Ndërsa gjatë vitit 2024 janë planifikuar të organizohen 4 trajnime bashkëpunuese dhe vizita mes mjekëve të spitaleve Sllovene dhe mjekëve të Spitave të Përgjithshme të Gjilanit dhe Prizrenit. Për secilën trajnim mjekët nga Kosova do të kenë mundësinë të vizitojnë spitalet në slloveni dhe të përfitojnë nga përvoja e organizimit të punës në këto spitale, ku gjithashtu ekipi i mjekëve nga Sllovenia do të kenë mundësinë të vizitojnë spitalet e Gjilanit dhe Prizrenit.

Nga muaji Nëntor deri në fund të muajit Dhjetor një kirurg nga Spitali i Përgjithshëm Prizren ka marrë pjesë në trajnimin nga lëmia e kirurgjisë së fëmijëve me temë “Teknikat kirurgjike minimale invazive tek fëmijët (Laparoskopia, Torakoskopia, Uro-gastoendoskopia). Trajnimi është mbajtur në Universitetin e Trakyas, Fakulteti i Mjekësisë, Klinika e kirurgjisë së fëmijëve Edirne.

Gjithsej trajnimi ka zgjatur 303 orë të rregullta punë dhe orë shtesë të kujdestarisë, gjatë së cilës janë kryer 115 intervenime kirurgjike.

Fokus i trajnimit ka qenë “Training Laparoskopik Box”, ku gjithashtu është diskutuar në mënyrë multidisiplinare nga ana e neonatologut, gjinekologut perinatologut, specialistit të gjenetikës, kirurgëve të fëmijëve mbi anomalitë që mund të paraqiten në kohën e shtatzënisë dhe masat të cilat duhen të ndërmerren para dhe pas lindjes së fëmijës.

Në fund të trajnimit mjeku nga Spitali i Përgjithshëm Prizren është pajisur me certifikatë për laparoskopi, torakoskropi dhe urogastroendoskopi. Si dhe për angazhimin dhe suksesin e treguar ka marrë mirënjohje për shkëmbim të përvojave gjatë qëndrimit në klinik.

Në bazë të Planit Nacional për Stroke 2022-2025 është planifikuar të trajnohen një neurolog dhe dy radiolog jashtë Kosovës për realizimin e trombektomisë mekanike. Pas hulumtimit nga mjekët e klinikës së Neurologjisë është kontaktuar Spitali Univsitar Aydin ne Stamboll ku dhe i është aprovuar mjekëve pjesëmarrja në trajnim nga kjo klinikë. Trajnimi nga lëmia e neurologjisë/radiologjisë do të zgjasë 12 muaj, duke filluar nga muaji Tetor. Në trajnim do të marrin pjesë dy specialist të radiologjisë, të punësuar në Klinikën e Radiologjisë në QKUK dhe një specialist i neurologjisë i punësuar në Spitalin e Përgjithshëm i Mitrovicës. Financimi për këtë trajnim është bërë në bazë të konkursit publik të OMK-së për përkrahjen e veçantë financiare dhe gjithashtu me mjete financiare nga fondi i deleguar sipas marrëveshjes DAFI me Lux-Dev projekti KSV/017.

Programi i trajnimit do të ketë fokus procedurat neurointervente-trombektomi mekanike, coiling, embolizim dhe stentim të arterieve.. Ky trajnim hyn në kuadër të edukimit të vazhdueshëm profesional i cili mundëson aplikimin e metodave të reja të trajtimit me benefit direkt të pacientëve me Stroke e që do të rezultonte në shërbime më cilësore dhe efikase.

Në kuadër të marrëveshjes mes Oda e Mjekëve të Kosovës dhe projektit Luxembourg Development KSV/017, është nënshkruar marrëveshje partneriteti me Spitalin Hayat në Bursa të Turqisë. Mjekët nga Spitali i Përgjithshëm i Prizrenit dhe Gjilanit do të kenë mundësinë të mbajnë trajnime që do të zgjasin mbi një muaj e që në fokus do të kenë lëminë e Ortopedisë dhe Gjinekologjisë me Obstetrikë.

Si rezultat i kësaj marrëveshjes gjatë muajit Nëntor dy mjekte specialiste të Gjinekologjisë dhe Obsterikës nga Spitali i Përgjithshëm Gjilan kanë mbajtur trajnimin nga lëmia e Gjinekologjisë dhe Obsterikës në Spitalin Hayat. Në programin e këtij trajnimi është përfshirë Histerektomia totale abdominale me adnexis, Ekcizioni i cistit ovarian ose paraovarian, Adenoidektomia dhe tubale, Tuboplastika dhe Histerektomia subtotale.

Ndërsa gjatë vitit 2024 planifikohet që bashkëpunimi në organizim të trajnimeve mes OMK dhe Spitalit Hayat të zgjerohet edhe në lëmi tjera.

### 13.3. Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike

Në kuadër të kompetencës publike lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë profesionale të mjekëve, Kryetari i OMK-së duke u bazuar në kompetencat ligjore sipas Ligjit për OPSh-të, në bazë të kërkesave nga Këshilli Etik i OMK-së, Prokurori i OMK-së, Gjykatat Themelore ka caktuar ekspert apo grupe të ekspertëve lidhur me konstatimin e përgjegjësisë profesionale mbi zbatimin e procedurave mjekësore nga mjekët gjegjës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën tetor-dhjetor	Vendimet sipas urdhëresave/kërkesave të pranuar për periudhën tetor-dhjetor	Në procedurë	Raportet e ekspertizave të përfunduara për periudhën tetor-dhjetor	Vendime për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
<b>Kryetari i Odës</b>	1	0	10	2	12

## 14. Plani i veprimit për 2024

### Projektet/Planet 2024

- Fillimi i zbatimit të Projektit për ndërtimin e objektit për të gjitha OPSh-të, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për Sektorin e Shëndetësisë” dhe OPSh-të.
- Fillimi i zbatimit të sistemit informativ/bazës interaktive të të dhënave, ku do të përfshihen të gjitha proceset e OMK-së. Kohëzgjatja e projektit është 2.5 vite.
- Organizimi i Kongresit të VI multidisiplinar



- Vazhdimi i zbatimit Zbatimit të projekteve për profilizim dhe shkollim specialistik jashtë vendit
- Vazhdimi i zbatimit të Marrëveshja për Delegimin e Fondeve dhe Implementim KSV/017-21 2749, faza e dytë për bashkëfinancimin e projektit të profilizimit të mjekëve
- Hulumtim për vlerësimin e ngarkesës së sëmundjes kronike dhe sindrominit burnout (shpenzimi profesional i mjekëve).